8. Raportime në MASR **për detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi nga zbatimi i vendimet gjyqësore** të formës së prerë të likujdura me fonde buxhetore për periudhën 2020-2021
9. Analizë dhe përgatitje e shkresave sipas problematikave të konstatuara.
10. Analizë ,përgatitje e autorizimeve dhe likujdimin e shpenzimeve për udhëtime e dieta të punonjësve konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
11. Analizë dhe përgatitje e shkresave për fonde për pagesën nga fondi i vecantë të punonjësve të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave drejtuar MASR dhe likujdimi i tyre nga ana e ZVAP -e;
12. **Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2022-2024**, sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave , Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, si standardeve te **Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 te Ministrin te Financave dhe Ekonomisë**, Udhëzimin Nr.8, datë 28.02.2019 ”Mbi përgatitjen e e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 117, datë 13.3.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
13. Monitorimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionet e vartësisë. Pjesëmarrje në grupin e punës për përgjigjet e ankesave që vijnë në platformën për bashkëqeverisjen.
14. Raportimi mujor i punonjësve që mbushin moshën për pension për DRAP+12 ZVAP
15. Përditësimi i data baze së punonjësve dosjet elektronike te punonjësve DRAP+12 ZVAP-e
16. Ndjekja e procedurave për emërim apo komandim të përkohshëm të drejtuesve të IA,në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” ,Punonjës të shërbimit psiko-social dh oficerët e sigurisë.
17. Marrja e informacionit nga të gjitha IA për numrin e nxënësve, klasave, personelit mësimor dhe ngarkesat javore të çdo mësuesi.
18. Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, specialistja e burimeve njerëzore ka përgatitur/hartuar dokumentacionin ligjor të përfaqësimit të DRAP ,MAR.DPAP, si autorizime, prapësime, ankime, kundërankime, për 14 çështjet gjyqësore në të cilët ka qenë palë ndërgjyqëse në vitin 2021, si dhe ankimet/kundërankimet dhe rekurset/kundër rekurset për çështjet të ndjekura para vitit 2021. Në kuadër të përgatitjes së prapësimeve, sektori ka bashkëpunuar dhe me njësi të tjera në ZVAP

19. Sektori ka administruar dosjen e çdo çështjeje gjyqësore të ngritur në vitin 2020-2021, si dhe ka plotësuar në vijimësi të ecurisë gjyqësore të çështjeve të administruara pranë tij, gjithë dokumentacionin që i përket secilës çështje, si vendimin gjyqësor përkatës, ankimin/kunderankimin, rekursin/ kundër rekursin, si dhe

dokumentet/akte të tjera të depozituar në cilësinë e provës.

20. Sektori ka përfaqësuar dhe vijon përfaqësimin e DRAP në seancat gjyqësore për të gjitha çështjet ku është palë ndërgjyqëse, dhe MAS M dhe DPAP në zbatim të autorizimeve përkatëse

3.7-Sektori i Kurrikulës dhe zhvillimit profesional

Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Durrës, mbështetur në detyrat e përcaktuara në VKM Nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, përcaktoi për vitin 2021, objektivat e mëposhtme:

- I. Objektivi i parë – Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar**
- II. Objektivi i dytë – Zhvillimi profesional i mësuesve**
- III. Objektivi i tretë – Zbatimi i akteve nënligjore dhe udhëzimeve të Ministrisë për IAP dhe ZVAP**
- IV. Objektivi i katërt – Mbështetja e IAP dhe ZVAP për zhvillimin e kurrikulës**

1- Një nga sfidat e implementimit të kësaj kurrikule siç parashikohet edhe në Strategjinë Kombëtare, vazhdon të mbetet siguri i infrastrukturës që ofron mundësi në përdorimin dhe përmbajtjen digjitale të procesit mësimor. Për këtë është treguar kujdes në aftësimin e personelit mësimor në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie duke ofruar trajnime të vazhdueshme. Për më tepër që situata e krijuar nga pandemia COVID-19 e ka bërë këtë sfidë prioritare në të gjithë institucionet kaskadë, që nga MASR dhe deri tek Institucioni Arsimor. Unifikimi i platformave të mësimin online, pajisja me infrastrukturë hardëare tablet, PC, mësimet në RTSH etj. janë disa nga masat e marra në përmbushje të realizimit të objektivave dhe treguesve matës që institucionet arsimore kanë për të konkuruar mes tyre me anë të Kartës së Performancës.



I. Monitorimi dhe studimi i skenarëve për zhvillimin e procesit mësimor në kushtet e pandemisë

➤ Të dhëna për mësimin online në kushtet Covid-19

Me urdhër të MASR-së është ndërprerë procesi mësimor më datë 09.03.2020, duke vijuar me zhvillimin e procesit mësimor në dy forma: orë mësimore në Radio Televizionin Shqiptar (RTSh) dhe mësimin online sipas lëndëve dhe klasave nga mësuesit lëndorë. Në vijim të punës për zhvillimin e mësimin në distancë, ndonëse të papërgatitur për këtë formë mësimdhënie, nga ana e mësuesve ka patur një angazhim maksimal për zhvillimin e mësimin, duke përdorur gjerësisht përgatitjen e materialeve mësimore në formatin video shoqëruar edhe me material të shkruar shpjegues. Mbledhja e informacioneve të përditësuara mbi skenaret e mësimin për çdo javë, lista e nxënësve që nuk kanë ndjekur mësimin online. Zbatimi i masave anticovid.

- 1. Skenari i parë:** 2.1. Shkollat me një turn dhe me numër të vogël nxënësish, të cilat plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik, në varësi të numrit të nxënësve do të zhvillojnë normalisht procesin mësimor në mjediset fizike të shkollës për klasat e arsimit fillor 1-5 dhe për klasën 12-të të AML.12.6% e shkollave nën varësinë e DRAP Durrës ndoqën skenarin 2.1 (21414 nxënës).

- 2. Skenari i dytë:** 2.2.Shkollat me një turn dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik.

Klasat 1-5 të arsimit fillor dhe klasa e 12-të e arsimit të mesëm të lartë do të zhvillojnë normalisht procesin mësimor në mjediset fizike të shkollës, siç veprohet në skenarin 1 të udhëzuesit për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021. Klasat 6 -9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin sipas varianteve si më poshtë: Varianti A Java tek → Grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 8.00-11.15 dhe do të zhvillojë mësim online gjatë tri ditëve e tjera të javës, nga ora 12.30-15.45. → Grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim online gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 12.30-15.45, dhe do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës, gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 8.00-11.15. Java çift → Grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 8.00-11.15 dhe do të zhvillojë mësim online gjatë tri ditëve të tjera të javës nga ora 12.30-15.45. → Grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim online gjatë dy ditëve të para të javës nga ora 12.30-15.45 dhe do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë tri ditëve të tjera të javës nga ora 8.00-11.15.Pra 10.1% e shkollave ndoqi këtë skenar (37070 nxënës).

- 3. Skenari i tretë:** 2.3.Shkollat me dy turne dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik.15% e shkollave ndoqën këtë skenar (66905 nxënës).

Ka patur dhe shkolla të cilat kanë zhvilluar mësimin rregullisht duke ndjekur skenarin 1. Gjithsej kanë qenë 62% e shkollave (41136 nxënës)

Pas rivlerësimit të situatës pandemike u vendos që shkollat e ZVAP-ve pa rrezik (zona jeshile) do të ktheheshin në shkollë për të ndjekur mësimin rregullisht (45min), ndërkohë shkollat e ZVAP Durrës, Tiranë dhe Kamëz do të vazhdonin mësimin me skenarë.

55.4% e shkollave ndoqën skenarin 1. Pra nga 704 shkolla, këtë variant e zbatuan 390 shkolla (47080 nxënës).

9% e shkollave ndoqën variantin 2.1, pra 64 shkolla (17001 nxënës).

6.96% e shkollave ndoqën skenarin 2.2, pra 49 shkolla (24625 nxënës).

11.1% e shkollave ndoqën skenarin 2.3, pra 78 shkolla (54052 nxënës).

17% e shkollave ndoqën skenarin 3, pra 123 shkolla (33972 nxënës).

II.Provimi i shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit 2021

Në vitin 2021, një ndër veprimtaritë në lidhje me certifikimin e mësuesve për ushtrimin e profesionit, ka qenë edhe procedura për regjistrimin e tyre për dhënien e provimit të shtetit. Gjatë muajit prill u shqyrtuan dhe u certifikuan për të dhënë provimin e shtetit **671** kandidatë nga të gjitha ZVAP në varësi të DRAP DURRËS. Rezultatet për provimin e shtetit, mbështetur në të dhënat e dërguara nga QSHA, Drejtoria e Provimeve të shtetit, tregojnë se **nota mesatare** e rezultateve të të gjithë kandidatëve pjesëmarrës është **6.7**, kurse **kalueshmëria 55%**.

Tabela e të dhënave për pjesëmarrjen dhe rezultatet e provimit të shtetit 2021

Nr	Profili	Të rregjistruar	Pjesëmarrës	Kalues	Jokalues	Mungesa	Nota mesatare	Kalueshmëria
1	Arsim Fillor	211	164	58	106	47	6	35.4
2	Arsim Special	21	20	15	5	1	7	75
3	Arte Figurative	1	1	1	0	0	8	100
4	Biologji	9	5	3	2	4	7	60
5	Biologji-Kimi	34	18	2	16	16	7.5	11.1
6	Edukim Fizik	47	42	35	7	5	7	83.3
7	Fizikë	26	19	9	10	7	6	47.4
8	Gjeografi	38	23	10	13	15	6.9	43.5
9	Gjuhë Angleze	43	44	36	8	9	7.2	81.8
10	Gjuhë Frënge	12	9	5	4	3	6	55.6
11	Gjuhë Gjermane	1	1	0	1	0	0	0
12	Gjuhë Greke	1	0	0	0	1	0	0
13	Gjuhë Italiane	13	7	4	3	6	6.2	57.1
14	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	60	52	41	11	18	6.9	78.8
15	Histori	42	31	23	8	11	6.7	74.2
16	Histori-Gjeografi	14	8	4	4	6	6.7	50
17	Histori-Gjeografi-Edukatë	3	2	1	1	1	7	50
18	Informatikë	3	3	2	1	0	6.5	66.7
19	Instrumente Muzikore	4	3	2	1	1	8.5	66.7
20	Kimi	10	6	5	1	4	6.2	83.3
21	Matematikë	23	21	15	6	2	6.9	71.4
22	Matematikë-Fizikë	12	9	2	7	3	5.5	22.2
23	Matematikë Informatikë	23	19	4	15	4	6.2	21.1
24	Shkenca Sociale	20	14	12	2	6	7	85.7

Nga analiza e të dhënave, **42.7%** e tyre e japin këtë provim **për herë të parë**, kurse pjesa tjetër për **herë të dytë 34.8%**, **të tretë 13.2%**, **të katërt 3.7%**, **të pestë 3.5%**, **të gjashtë 1.4** dhe të shtatë **0.2%**. Nisur nga kërkesa për dhënien e provimit vihet re se:

o 31.4% e kandidatëve janë të profilit **”Arsim Fillor”**

o 8.9% e kandidatëve janë të profilit **”Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”**

Nga analiza e rezultateve, vihet re se:

o **77.6%** e kandidatëve të regjistruar **marrin pjesë në provim**

o **55.4%** e këtyre kandidatëve **janë kalues**

Kandidatët e profilit **”Matematikë-Fizikë”** kanë edhe **rezultatet më të ulëta** në këtë provim:

o **Nota mesatare – 5.5** o **Kalueshmëria – 22.2%**

Më pas renditen kandidatët e profilit:

o **Arsim fillor, Fizikë, Gjuhë Frënge, me note mesatare 6 dhe kalueshmëri 35.4%**

o **Arsim Special, Biologji, Edukim Fizik, Histori-Gjeografi-Edukatë, Shkenca Sociale me kalueshmëri 60%-83%** dhe notë mesatare **7**

Në bazë të kandidatëve pjesëmarrës renditen dhe kalueshmërie dhe nota mesatare e cila për degët e tjera sa vjen dhe rritet.

III.Ecuria e nismës “Shkolla si Qendër Komunitare”

Nisma “Shkolla si Qendër Komunitare”, filloi zbatimin e saj në vitin 2014 dhe prej asaj kohe deri tani ka pasur një rritje të interesit të shkollave për t’u bërë pjesë në këtë nismë.

Në vitin 2020, në DRAP Durrës, funksionuan 70 Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK).

34.2% në arsimin e mesëm të lartë (AML)

65.7% në arsimin e mesëm të ulët (AMU)

62.8% në qytet

37.2% në fshat

17711 nxënës janë përfitues të veprimtarive dhe shërbimit që ofrohet në këto shkolla

30890 prindër të nxënësve të shkollës janë përfitues nga shërbimet në këto shkolla

□ **354** mësues ofrojnë shërbimin dhe janë përfitues në këto shkolla

Për shkak të kushteve të krijuara nga situata e pandemisë së COVID-19, veprimtaria e këtyre shkollave për vitin 2020, ka qenë e kufizuar, por nuk është ndërprerë. Tabela e mëposhtme tregon ecurinë 7 vjeçare të kësaj nisme me të dhënat për të gjitha vitet sipas treguesve

INFORMACION PER SHKOLLEN QENDER KOMUNITARE 2014-2021


DRAP	ZV AP		2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021
DURRËS		TOTAL-SHKOLLA QENDER KOMUNITARE(SHQK)	14	56	58	58	69	70	70
DURRËS		SHQK-AML	7	21	21	21	23	24	24
DURRËS		SHQK -AML QYTET	3	17	17	17	17	18	18
DURRËS		SHQK -AML FSHAT	4	4	4	4	6	6	6
DURRËS		NXENES-AML PERFITUES	1910	17511	16736	16543	17468	17854	17711
DURRËS		PRINDER-NX.AML PERFITUES	3210	28334	30061	30605	10473	31354	30890
DURRËS		MESUES-AML PERFITUES	15	634	662	664	233	348	354
DURRËS		SHQK-AMU	7	35	37	37	46	46	46
DURRËS		SHQK -AMU ZONE QYTET	6	22	23	23	26	26	26
DURRËS		SHQK -AMU ZONE FSHAT	1	13	14	14	20	20	20
DURRËS		NXENES-AMU PERFITUES	1978	19009	18246	18145	21582	23480	22513
DURRËS		PRINDER-NX.AMU PERFITUES	1790	25675	26060	26428	27785	30192	28834
DURRËS		MESUES-AMU PERFITUES	80	499	486	507	666	422	413

Ecuria e nismës “Shkolla si Qendër Komunitare”

Nisma “Shkolla si Qendër Komunitare”, që ka filluar zbatimin e saj në vitin 2014 dhe prej asaj kohe deri tani ka pasur një rritje të interesit të shkollave për t’u bërë pjesë në këtë nismë.

Në vitin 2021-2022, në DRAP Durrës , funksionojnë 145 Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK).

DRAP		2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022
DURRËS	TOTAL-SHKOLLA QENDER KOMUNITARE(SHQK)	14	56	58	58	69	70	70	145



Grafiku i mësipërm tregon rritjen e numrit të shkollave nga viti 2014 me 14 shkolla si qendra komunitare, në 70 të tilla në fund të vitit 2021..


IV. Kualifikimi i mësuesve 2021

Pjesëmarrja e mësuesve

Pjesëmarrja e mësuesve Zhvillimi profesional i mësuesve është një nga detyrat themelore të punës për DRAP Durrës, por gjatë këtij viti, për shkak të kushteve të krijuara është punuar vetëm në identifikimin e nevojave që u zhvillua në bashkëpunim me ASCAP. Në vijim, është organizuar puna për realizimin e procesit të kualifikimit të mësuesve për vitin 2021, duke u ngritur grupet e punës dhe duke u orientuar të gjitha ZVAP për të vlerësuar me korrektësi portofolin personal dhe profesional të mësuesve. Kualifikimi i mësuesve për vitin 2021 u mbështet në Udhëzimin udhëzimit nr.4 datë 26.02.2021 “ Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve. Monitoruam me urdhër dhe platformë monitorimi ZVAP Tiranë, Kamëz. Nga kontrolli i dosjeve me kampionim në secilën prej zyrave rezultojnë se janë zbatuar përcaktimet sipas udhëzimit përkatës. Janë konstatuar disa gabime në pjesën e përfitimit të bonuseve gjuhë e huaj dhe master passhollimi për të cilat në bashkëpunim me institucionet përkatëse eprore dhe të varësisë janë marrë masa që të korrigjohen në kohë gabimet e konstatuara.

- Numri i mësuesve të DRAP Durrës që morën pjesë në kualifikim është 1366 kandidatë. Tabela e mëposhtme pasqyron rezultatet për çdo zvap për të gjitha profilet
- Pjesëmarrje më të madhe kanë mësuesit që japin mësim në nivelin e arsimit **9 vjeçar AMU 46%**

DRAP	PJESËMARRJA SIPAS CIKLEVE						
	AF	APSH	AML	AMU	AP	AS	ASK
	264	121	305	625	21	6	24
%	19.3	8.9	22.3	45.8	1.5	0.4	1.8




Vihet numri më i madh i kandidatëve që kanë kërkuar të fitojnë **kategorinë e tretë** (Mësues i kualifikuar), **52%** e të gjithë kandidatëve

SIPAS KATEGORISË



REZULTATE TË TESTIMIT 2021

NR.	DRAP	Nr. i mësuesve pjesëmarrës	Nr. i Ankimimeve për testin	Rezultate 2021					Rezultate 2021 në %					Total në %
				A	B	C	D	E	A	B	C	D	E	
	Total	1366	109	91	604	598	44	21	7	44	44	3	2	99



NR.	ZVAP në varësi	Nr. i mësuesve pjesëmarrës	Nr. i Ankimimeve për testin	Rezultate 2021					Rezultate 2021 në %					Total në %
				A	B	C	D	E	A	B	C	D	E	
1	Bulqizë	44	3	1	9	28	4	2	2	20	64	9	5	100
2	Dibër	86	5	1	32	47	4	2	1	37	55	5	2	100
3	Durrës	217	17	8	114	88	5	2	4	53	41	2	1	100
4	Kamëz	91	9	4	39	42	4	2	4	43	46	4	2	100
5	Kavajë	55	4	2	27	25	2	1	4	49	45	4	2	104
6	Klos	22	5	0	8	9	2	2	0	36	41	9	9	95
7	Krujë	58	13	3	13	39	2	1	5	22	67	3	2	100
8	Mat	49	6	0	17	26	2	2	0	35	53	4	4	96
9	Rrogzhinë	40	3	2	3	32	2	1	5	8	80	5	3	100
10	Shijak	35	1	1	17	17	0	0	3	49	49	0	0	100
11	Tiranë	631	39	69	312	220	17	6	11	49	35	3	1	99
12	Vorë	38	4	0	13	25	0	0	0	34	66	0	0	100
	Total	1366	109	91	604	598	44	21	7	44	44	3	2	99

I. Praktika profesionale e kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit


Praktika profesionale për vitin 2021

Praktika profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, mbështetur në Urdhrin Nr. 336, datë 14.07.2011, “Për miratimin e rregullores për “Organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 23.10.2019 “Për Kryerjen e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit” si edhe Urdhrit nr. 570, datë 04.12.2019 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 535, datë 06.11.2019 për shpërndarjen e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin shkollor 2019-2020, për institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar”, u zhvillua duke pasur parasysh përcaktimin e numrit të kandidatëve për çdo zyrë arsimore.

Ka përfunduar procesi i regjistrimeve për praktikën profesionale. Është bërë shpërndarja e tyre në shkolla sipas mentorëve duke ju respektuar dhe numrin e praktikantëve të miratuar nga MASR.

Aktualisht kemi 821 kandidatë të regjistruar për të zhvilluar praktikën profesionale.

Numri i kuotave, praktikantëve dhe mentorëve të praktikave profesionale për vitin shkollor 2020-2021					
N.r	DRAP Durrës	Nr. kuotave	Nr. Praktikantëve që kanë filluar pr. Profesionale	Nr. praktikantëve që kanë përfunduar pr. profesionale	Nr. Mentorëve
1	ZVA Durrës	167	156	147	110
2	ZVA Mat	12	11	10	10
3	ZVA Klos	9	6	6	6
4	ZVA Shijak	40	36	36	30
5	ZVA Kavajë	65	60	60	49
6	ZVA Bulqizë	8	5	5	5
7	ZVA Tiranë	489	413	406	376
8	ZVA Krujë	56	46	45	40
9	ZVA Vorë	32	28	28	23
10	ZVA Rrogozhinë	20	9	9	9
11	ZVA Dibër	23	23	19	19
12	ZVA Kamëz	67	68	66	55
	Total	988	861	837	732



Numri i kandidatëve për secilin profil që kanë përfunduar praktikën profesionale për në vitin shkollor 2020-2021

Profili	Nr. i praktikantëve për çdo profil	Nr. i mentoreve për çdo profil, sipas kategorisë së kualifikimit			
		kateg. 1	kateg. 2	kateg. 3	pa kategori kualifik.
Arsim Fillor	98	71	25	0	0
Arsim special	17	14	3	0	0
Arte Figurative	13	5	5	0	1
Biologji	29	15	10	0	0
Biologji Kimi	15	11	3	0	0
Edukim Fizik	108	46	43	1	0
Fizikë	20	14	4	0	0
Gjeografi	58	30	24	0	0
Gjuhë Angleze	109	33	54	1	2
Gjuhë Frënge	13	6	4	0	0
Gjuhë Greke	0	0	0	0	0
Gjuhë Gjermane	7	2	3	0	0
Gjuhë Italiane	23	7	11	0	2
Gjuhë shqipe dhe letërsi	124	66	43	0	0
Histori	63	29	24	0	0
Histori Gjeografi	13	5	7	0	0
Histori Gjeografi Edukatë	3	2	0	0	0
Informatikë	5	1	4	0	0
Instrumente Muzikore	9	5	4	0	0
Kimi	13	11	2	0	0
Matematikë	26	19	6	0	0
Matematikë Fizikë	4	1	3	0	0
Matematikë Informatikë	30	11	11	0	0
Shkenca Sociale	36	8	17	0	2
Gjuhë Turke	1	0	0	1	0
Total	837	412	310	3	7

- **Ndjekja e procesit të organizimit të Fazës së Dytë dhe të Tretë të Olimpiadave Kombëtare për vitin 2020-2021. Miratimi i komisioneve të administrimit dhe vlerësimit të testit.**

Monitorim i ZVAP-ve në zbatimin e udhëzimeve MASR-së dhe rregullores për organizimin e olimpiadave në ZVAP-të. Me prioritet kanë qenë ZVAP-të me numër më të madh nxënësish pjesëmarrës si: Tiranë, Durrës, Kavajë, Vorë, Kamëz

- **Ndjekja e procesit të organizimit të Fazës së Dytë të Olimpiadave Kombëtare për vitin 2020-2021. Miratimi i komisioneve të administrimit dhe vlerësimit të testit.**

a. Janë zhvilluar olimpiadat në të gjitha lëndët ku kemi fituesit sipas tabelës së mëposhtme:

Fitues Faza II Olimpiada Kombëtare										
Nr	ZVAP	Matematikë 9	Matematikë AML	Fizikë	Kimi	Biologji	Informatikë	Gjuhë dhe Letërsi	Histori	Gjeografi
1	Bulqizë	0	0	0	0	0	0	2	0	0
2	Dibër	0	0	0	1	0	0	23	0	3
3	Durrës	1	11	18	8	10	8	9	0	0
4	Kamëz	0	3	0	5	2	0	5	0	0
5	Kavajë	0	0	0	0	0	0	1	0	0
6	Klos	0	0	0	0	0	0	2	0	0
7	Krujë	0	0	0	0	0	0	3	0	0
8	Mat	1	0	2	0	0	0	5	0	0
9	Rrogozhinë	0	0	0	0	0	0	7	0	0
10	Shijak	0	0	0	0	0	0	76	3	5
11	Tiranë	1	6	3	25	27	10	2	0	0
12	Vorë	0	0	0	0	0	0	109	5	10
	TOTAL 412	3	20	23	39	39	18	244	8	18

Monitorim i ZVAP-ve në zbatimin e udhëzimeve MASR-së dhe regullores për organizimin e olimpiadave në ZVAP-të. Me prioritet kanë qenë ZVAP-të me numër më të madh nxënësish pjesëmarrës si:


- a. Tiranë
- b. Durrës
- c. Kavajë
- d. Vorë
- e. Kamëz

🇲🇸Rrjetet profesionale të mësuesve

Rrjetet profesionale për vitin 2020-2021 si një nga mënyrat më efektive për të realizuar zhvillimin profesional të mësuesve, janë krijuar duke u mbështetur në Udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017, “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, në DRAP Durrës dhe zyrat e arsimit parauniversitar në varësi të tij, janë krijuar dhe funksionojnë disa rrjete profesionale.

Këto rrjete profesionale kanë patur ndikim në përcjelljen e informacionit mes mësuesve, ndarjen e eksperiencave pozitive, zhvillim profesional të mësuesve.

Nga të dhënat e mbledhura për vitin 2021 janë krijuar dhe funksionojnë 351 rrjete profesionale, kryesisht në arsimin bazë (klasa VI-IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasa X – XII). Në këto rrjete marrin pjesë rreth 90% e të gjithë mësuesve të sistemit arsimor parauniversitar në DRAP Durrës.



➤ **Matura shtetërore 2020-2021**

- 1- Në zbatim të Urdhrit Nr.364, dt.24.12.2020, të MASR - "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2020 në Republikën e Shqipërisë" janë përcaktuar në bashkëpunim me ZVAP-të dhe DPAP-në qendrat e zhvillimit të provimit të Maturës Shtetërore. Pjesëmarrja e nxënësve në provimet e MSH 2021

LËNDA	NUMRI I QENDRAVE TE PROVIMIT	NUMRI I KLASAVE NË TË GJITHA GODINAT PER PROVIM	NUMRI I MATURANTËVE TË REGJISTRUAR PËR TESTIM GJITHSEJ SI ZVAP QSHA	NUMRI I MATURANTËVE QË MORËN NË TESTIM GJITHSEJ SI ZVAP	NUMRI I MATURANTËVE QË MUNGUAN NË TESTIM GJITHSEJ SI ZVAP	SA NGA MUNGESAT JANE MBETES OSE PK
Gjuhë e huaj	77	1107	15184	14752	432	227
Gjuhë shqipe dhe Letërsi	78	1138	15393	14919	474	216
Matematikë	77	1144	15057	14582	475	263
Zgjedhje	77	1141	15291	14853	438	204

- 1- **Me fokus monitorimin e cilësisë** dhe për të fuqizuar procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, në mënyrë që proceset vlerësuese të jenë të suksesshme dhe konform standardeve janë realizuar trajnime në bashkëpunim me QSHA dhe ASCAP për programet dhe testet e Maturës Shtetërore me mësuesit e lëndëve gjuhë shqipe, matematikë, TIK

REZULTATET E MSH 2021

1. Arritjet e nxënësve në Gjuhë shqipe dhe Letërsi - statistika krahasuese

Tabela e mëposhtme jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e Maturës Shtetërore në nivel DRAP/ZVAP, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, notën mesatare vjetore, si dhe diferenca (NM-NV).

Nr.	ZVAP	Kalueshmëria në provimin e Maturës Shtetërore	Nota Mesatare e Maturës Shtetërore (NM)	Nota Mesatare Vjetore (NV)	Diferenca e Notës së Maturës Shtetërore me Vjetoren NM-NV Gjuhë Shqipe dhe Letërsi
1	BULQIZË	98.53%	6.91	7.24	-0.33
2	DIBËR	98.49%	6.81	7.16	-0.35
3	DURRËS	97.78%	6.37	6.79	-0.43
4	KAMËZ	98.97%	7.15	6.82	0.34
5	KAVAJË	98.81%	6.83	7.31	-0.48
6	KLOS	97.70%	6.60	6.87	-0.27
7	KRUJË	98.83%	6.90	6.99	-0.09
8	MAT	99.31%	7.03	7.14	-0.10
9	RROGOZHINË	98.70%	6.87	7.01	-0.14
10	SHIJAK	98.43%	6.97	7.50	-0.54
11	TIRANË	99.10%	7.27	7.73	-0.46
12	VORË	98.34%	7.22	7.19	0.03

2. Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese

Tabela e mëposhtme jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e Maturës Shtetërore për lëndën e Matematikës, në nivel DRAP/ZVAP, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, notën mesatare vjetore, si dhe diferencën (NM – NV)

Nr.	ZVA	Kalueshmëria në provimin e Maturës Shtetërore	Nota Mesatare e Maturës Shtetërore (NM)	Nota Mesatare Vjetore (NV)	Diferenca e Notës së Maturës Shtetërore me Vjetoren NM-NV
1	BULQIZË	95.56%	5.59	6.40	-0.82
2	DIBËR	96.64%	6.36	6.46	-0.10
3	DURRËS	98.93%	6.62	6.65	-0.03
4	KAMËZ	96.17%	5.60	6.24	-0.65
5	KAVAJË	100.00%	8.62	6.99	1.63
6	KLOS	96.23%	5.52	5.95	-0.44
7	KRUJË	98.87%	6.70	6.79	-0.09
8	MAT	100.00%	6.02	6.14	-0.11
9	RROGOZHINË	100.00%	7.23	6.77	0.46
10	SHIJAK	98.59%	6.61	6.51	0.10
11	TIRANË	99.07%	6.56	6.98	-0.42
12	VORË	99.62%	6.29	6.35	-0.06

3. Arritjet e nxënësve në Gjuhën e Huaj - statistika krahasuese

Tabela e mëposhtme jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e Maturës Shtetërore në nivel DRAP/ZVAP mbi, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, notën mesatare vjetore, si dhe diferencën (NM-NV)

Nr.	DAR/ZA	Kalueshmëria në provimin e Maturës Shtetërore	Nota Mesatare e Maturës Shtetërore (NM)	Nota Mesatare Vjetore (NV)	Diferenca e Notës së Maturës Shtetërore me Vjetoren NM-NV
1	BULQIZË	89.33%	5.75	6.77	-1.03
2	DIBËR	96.45%	6.97	6.68	0.29
3	DURRËS	98.77%	7.36	7.21	0.15
4	KAMËZ	95.62%	6.92	6.77	0.15
5	KAVAJË	99.38%	8.6	7.59	1.01
6	KLOS	98.11%	5.95	6.39	-0.44
7	KRUJË	98.88%	7.21	6.91	0.3
8	MAT	100.00%	6.56	7.05	-0.49
9	RROGOZHINË	96.62%	7.24	7.31	-0.06
10	SHIJAK	99.30%	6.87	7.07	-0.2
11	TIRANË	98.63%	7.99	7.88	0.11
12	VORË	98.88%	7.08	6.99	0.1

➤ **Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, nenit 49, pika 1, nenit 50 të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të Udhëzimit Nr.9, datë 09. 04. 2021 “Për miratimin e rregullore për zhvillimin e Provimit Kombëtar të Arsimit Bazë, në Republikën e Shqipërisë viti shkollor 2020-2021”; në zbatim të nenit 6 pika 3, të Urdhërit Nr. 72, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullore për zhvillimin e Provimit Kombëtar të Arsimit Bazë, në Republikën e Shqipërisë”, janë zhvilluar provimet kombëtare në lëndët Gjuhë Shqipe, Matematikë, Gjuhë e huaj

ZVAP	Nr. i qendrave të provimit si ZVAP	Nr. i shkollave si ZVAP	Nr. i nxënësve të regjistruar për provim si ZVAP	Nr. i nxënësve pjesëmarrës në provim si ZVAP	Nr. i nxënësve të munguar në provim si ZVAP	Nr. Total PAP	Nr. Total AP	Nr. Total AS	Nr. Total PK
TOTAL	167	397	14736	14578	158	167	1277	279	221

➤ **Provimet VANAF**

- Udhëzimit Nr. 6, datë 31.3. 2021 “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2020-2021”; Urdhërit Nr. 78, datë 27.02.2020, “Për miratimin e rregullore për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor”, Urdhërin Nr.75, datë 18. 05. 2021 “Për monitorimin e procesit të zhvillimit të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor”, me datën 21.05.2021, u zhvillua testimi i nxënësve të klasave të pesta “Për zhvillimin e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor, viti shkollor 2020-2021”.
- Me autorizimin të drejtores së DRAP Durrës, pëfaqësues të DRAP Durrës monitoruan procesin e hedhjes së shortit për shpërndarjen e PAP-ve, AP-ve dhe AS-ve në qendrat e provimeve, në ZVAP-të nën juridiksionin e DRAP Durrës, si dhe dhe procesin e zhvillimit të provimit në Qendrat e Provimit të përzgjedhura me kampinim.

➤ Nga raportimet e monitoruesve që DRAP Durrës ka autorizuar rezulton se janë 198 qndra provimi dhe 423 shkolla pjesëmarrëse. Nxënës të regjistruar për zhvillimin e provimit janë 14436 nxënës, të munguar 373 nxënës dhe pjesëmarrës janë 14063 nxënës. Të dhënat sipas tabelës së mëposhtme:

DRAP	Nr. i qendrave të provimit	Nr. i shkollave pjesëmarrëse	Nr. i nxënësve pjesëmarrës në provim për çdo qendër	Nr. i nxënësve të munguar për secilën qendër provimi	Problematika që dolën gjatë procesit
DURRËS	198	423	14436	373	Nu ka probleme

2- Procesi i përzgjedhjes së teksteve është bërë në zbatim të urdhërit nr.46, datë 16.03.2021. Nga IAP-të dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar është bërë plotësimi i formularit të përzgjedhjes duke u mbështetur në katalogun e teksteve shkollore. Sipas afateve dhe kërkesave procesi i përzgjedhjes së teksteve është përmbyllur me sukses. Për këtë proces u monitoruan në bashkëpunim me ZVAP-të institucione arsimore si me poshtë:

Nr.	ZVAP	Numri i IA publike për monitorim				
		Gjithsej	9-vjeçare qytet	9-vjeçare fshat	Gjimnaze	SHMB
	DRAP Durrës	100	38	25	25	12

Portali “Mësues për Shqipërinë” 2021

Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e te emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, shkresa Nr.3375 prot, datë 14.06.2021 Për realizimin e procedurave të konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021, është realizuar procesi i vlerësimit të kandidatëve aplikantë në portal. Nga database e të dhënave kemi këtë përmbledhje

- 1-Aplikante gjithsej në DRAP Durrës **3904**
- 2-Aplikante që kanë dorëzuar dosjen fizike **3822**
- 3-Aplikante që hyjnë kanë hyrë në testim **2734**
- 4-Skualifikime gjithsej **218** nga të cilat **82** nuk kanë dorëzuar dosje fizike dhe **136** kanë mosaplikim online ose mungesa në dokumenta sipas përcaktimeve të udhëzimit 12
- 5-Numri i ankesave te trajtuara **289 faza pare. 5** në bashkëqeverisje . **Total 294**

Problematika të Portalit.

- 1- Kohë jo e mjaftueshme për vlerësim të dosjeve fizike dhe online (referuar numrit të lartë të aplikimeve që ka DRAP Durrës).
- 2- Libreza e punës në shumë raste e pa mbyllur kur kandidati ishte I papunë aktualisht si dhe problematika e Udhëzimit 12 shtojca 1 ku thuhej libreza të dorëzohet në momentin e punësimit (Kjo ka rritur dhe numrin e ankimimeve sepse nuk e kanë të depozituar në dosje librezën)
- 3- Mos aplikimi online për probleme të sistemit. Për këtë rihapja e sistemit dhe riaplikimi për kandidatët nga KVD shtoi volumin e punës, ngarkesën jashtë orareve për të arritur në kohë shpalljen e rezultateve.
- 4- Mungesa e një specialist IT në sektorin e SKZHP për specifika të portalit por jo vetëm.
- 5- Stafi i SKZHP duhet të rritet referuar dhe volumit të punës që ka DRAP Durrës në krahasim me DRAP-et e tjera pasi ka % më të lartë të shkollave dhe nxënësve

2- Veprimtari për zhvillimin profesional për të përmirësuar aftësitë e drejtuesve dhe mësuesve në fushën e kurrikulës.

Në bashkëpunim me ASCAP si dhe OJF janë bërë bashkëpunime frytdhënëse lidhur me realizimin e procesit të trajnimit të mësuesve për DRAP Durrës në përmblyshje të nevojave të tyre për trajnim. Trajnimet janë kryer me pjesëmarrje fizikisht dhe online gjatë periudhës së pandemisë në platformën Zoom.

Moduli që u ofrua në këtë trajnim: Mësimdhënia në kurrikulat e reja.

– **Organizatori: DRAP Durrës në bashkëpunim me Qendra e Trajnimeve dhe Projekteve, Albas**


- a- Trajnimi i personelit arsimor në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të ZVAP-ve Tiranë dhe ZVAP Vorë
- b- **Me fokus monitorimin e cilësisë** dhe për të fuqizuar procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, në mënyrë që proceset vlerësuese të jenë të suksesshme dhe konform standardeve është realizuar trajnimi i drejtuesve të IA-ve, PAP-ve, AP-ve, PK-ve për rregulloren e Maturës Shtetërore.
- c- **Trajnim me drejtuesit e rrjeteve profesionale** Hartimi i planeve vjetore mësimore bazuar në temat mësimore për arsimin e mesëm të ulët (AMU) , arsimin e mesëm të lartë (AML) të hartuara nga ASCAP dhe të Miratuara nga MASR me Urdhër nr.265 datë 24.08.2020.

Nxënësit kandidatë për "Medaljen e Artë"

Mbështetur në Udhëzimit nr. 7. datë 08.04.2021, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së medaljes së artë", për vitin 2021 u shpallën kandidatë fitues të "Medaljes së Artë", nxënësit e mëposhtëm:

Emri	Mbiemri	DRAP/ZVA	Shkolla	Klasë	Nota mesatare e shkolles se mesme	D1	D2	D3	ZI	Olimp. ndërkombëtare
Fabian	Kryemadhi	DURRËS/TIRANË	Ismail Qemali	12	10	9.78	9.64	9.86	10	
Glenda	Hoxha	DURRËS/TIRANË	Ismail Qemali	12	10	9.75	9.88	9.75	10	
Gridis	Mollosmani	DURRËS/TIRANË	Ismail Qemali	12	10	9.78	9.81	9.78	10	
Griselda	Harremi	DURRËS/TIRANË	Petro Nini Luarasi	12	10	9.6	9.85	9.96	10	
Helena	Stroka	DURRËS/TIRANË	Petro Nini Luarasi	12	10	9.6	9.74	9.91	10	
Kejsi	Kordha	DURRËS/TIRANË	Petro Nini Luarasi	12	10	9.5	9.67	9.86	10	
Grasjela	Lugja	DURRËS/TIRANË	Petro Nini Luarasi	12	10	9.75	9.6	9.78	10	
Rozana	Leka	DURRËS/TIRANË	Petro Nini Luarasi	12	10	9.75	9.91	9.75	10	
Iris	Nuri	DURRËS/TIRANË	Partizani	12	10	9.75	9.67	9.86	10	
Danjela	Rexhaj	DURRËS/TIRANË	Qemal Stafa	12	10	9.78	9.53	9.91	10	
Erin	Kërçiku	DURRËS/TIRANË	Sami Frasheri	12	10	9.91	9.91	9.91	10	
Tea	Kodra	DURRËS/TIRANË	Sami Frasheri	12	10	9.81	9.81	9.81	10	
Sotir	Xhixho	DURRËS/TIRANË	Sami Frasheri	12	10	9.6	9.53	9.6	10	
Emida	Qafa	DURRËS/TIRANË	Ernest Koliqi	12	10	10	9.91	9.96	10	
Dejv	Agaraj	DURRËS/TIRANË	Dertliu	12	10	9.86	9.97	9.78	10	
Markli	Hoxha	DURRËS/TIRANË	Mehmet Akif Djem	12	10	9.75	9.94	9.81	10	
Esti	Dautaj	DURRËS/TIRANË	Turgut Ozal	12	10	9.5	9.57	9.81	10	
Gea	Ivanaj	DURRËS/TIRANË	Turgut Ozal	12	10	9.6	9.71	9.96	10	
Henri	Olldashi	DURRËS/TIRANË	Turgut Ozal	12	10	9.5	9.97	9.96	10	
Inva	Muçi	DURRËS/TIRANË	Turgut Ozal	12	10	9.55	10	9.91	10	
Kejsi	Shehu	DURRËS/TIRANË	Turgut Ozal	12	10	9.75	9.81	9.91	10	
Sarah	Qirjako	DURRËS/TIRANË	Turgut Ozal	12	10	9.65	9.53	9.78	10	
Skerdi	Progri	DURRËS/TIRANË	Woodrow Wilson	12	10	9.6	9.91	9.91	10	
Rebeka	Çaka	DURRËS/KAVAJË	Gjimnazi "Aleksandë	12	10	9.65	9.91	9.81	10	
Alesia	Hoti	DURRËS/DURRËS	Rilindja	12	10	9.65	9.81	9.81	10	
Alonsio	Medolli	DURRËS/DURRËS	Turgut Ozal	12	10	9.78	9.6	9.96	9.91	2
Dea	Myshketa	DURRËS/DURRËS	Turgut Ozal	12	10	9.5	9.74	9.86	9.86	1
Klajdi	Kaçiu	DURRËS/KRUJË	Skëndërbeu	12	10	9.55	9.5	9.64	10	

ZVAP	TOTAL	PUBLIK	PRIVAT
TIRANË	23	13	10
DURRËS	3		3
KAVAJË	1	1	
KRUJË	1	1	



- Nxënësit që ndjekin mësimin në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë jopublike kanë rezultate më të larta në krahasim me të gjithë nxënësit që ndjekin mësimin në insitucionet e arsimit publik;
- Nxënësit që ndjekin gjimnazin në zonat urbane (qytete) kanë arritjet më të larta në krahasim menxënësit që ndjekin shkollën në shkollat e mesme në zonat rurale;

SHËRBIMI PSIKO-SOCIAL

III.Zbatimi i Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko- social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”

Në zbatim të Urdhrit të sipërcituar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës nga kërkesat e ardhura nga të gjitha institucionet në varësi të saj shpalli vendet vakante dhe provizore për këtë shërbim.Pas shpalljes së vendeve të lira për punonjës të shërbimit psiko-social u zhvilluan procedurat për punësimin e tyre sipas përcaktimeve të Urdhrit 313, datët 20.10.2020.Nga analiza e numrit të nxënësve për shkollë, numrit e nxënësve me aftësi ndryshe, dhe numri të shkollave speciale, u shpallën **29 vende total**. Nga këto 21 vende psikolog dhe 8 vende punonjës social.Komisioni Ad-hoc pranë DRAP Durrës i përbërë nga përfaqësues të MASR, ASCAP DPAP dhe DRAP vlerësoi **68** dosje për konkurrim, prej të cilave **39** kandidatë kaluan në fazën finale. Për kandidatët fitues janë bërë punësimet duke zbatuar pikëzimin final. Kanë mbetur ende pa u plotësuar 2 vende në ZVAP Dibër, 1 vend në ZVAP Mat, 1 vend në ZVAP Bulqizë, 1 vend në ZVAP Tiranë (provizor)

3.8 - Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës

Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës për vitin 2021, në zbatim të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99,datë 27.02.2019 " Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar ", urdhërit nr.68,datë 05.04.2019, për "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar",”Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" me nr.4699/1 prot, datë,30.04.2019, ka kryer inspektime në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në juridiksion të saj.

Theksojmë se qëllimi i inspektimeve, të realizuara, ka qenë dhe është verifikimi i funksionimit të IA dhe ZVAP në raport me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe ndikim në cilësinë e menaxhimit të brendshëm të tyre.

Konkretishtë inspektimet me natyrë vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në DRAP Durrës janë orientuar nga plani vjetor dhe ai mujor, por dhe nga problematikat e diktuar nga portali i “ Bashkëqeverisjes me Qytetarët”

Nga periudha janar-dhjetor 2021SIVC ka kryer 45 inspektime ne IAP dhe 2 inspektime ne ZVA.

Gjithashtu kemi menaxhuar 15 ankimime te ardhura nga “ Portali i Bashkeqeverisjes” nga prinder e mesues.

Theksojmë se inspektimet me natyrë vlerësimi janë mbështetur në Manualin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të IA. SIVC ka monitoruar ZVAP Tiranë , ZVAP Kamëz ,ZVAP Vorë,ZVAP Rrogozhinë,ZVAP Kavajë,ZVAP Durrës me tematikë për masat e marra, për sigurimin e kushteve në çdo institucion arsimor, sipas udhëzimeve të MASR-së . Janë monitoruar me tematikë për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, në përputhje me “skenarin 2”, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar, janë monitoruar me qëllim vlerësimin emasave të marra nga shkolla për përzgjedhjen dhe porositjen e teksteve shkollore për vitin shkollor 2021-2022 në 8 IA :

Është synuar të vlerësohen treguesit që kanë të bëjnë me hartimin e dokumentave kryesor për funksionimin e IA; plani afatmesëm, plani vjetor i shkollës, rregullorja e brendshme, mënyra e monitorimit dhe dokumentimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës, bashkëpunimi i shkollës me aktorët dhe faktorët që janë përfitues të shërbimit arsimor, ose të interesuar për cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe shërbimi psiko-social.

Vlerësohet fakti se Sektori i Inspektimit ka dalë me përfundime, ka dhënë rekomandime dhe ka verifikuar zbatueshmërinë e tyre për IA, me synim përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të shkollës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin: